UDHËZIM
Nr. 47, datë 31.12.2020

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 34, DATË 14.9.2020, "PËR MËNYRËN E EMËRIMIT DHE TË LIRIMIT NGA DETYRA TË PUNONJËSVE TË AKPA-s, QË TRAJTOHEN ME KODIN E PUNËS"

Në mbështetje ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", si edhe të Kodit të Punës së RSH-së,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 34, datë 14.9.2020, "Për mënyrën e emërimit dhe lirimit nga detyra të punonjësve të AKPA-s, që trajtohen me Kodin e Punës", bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Neni 13 ndryshohet si vijon:

"Neni 13
Kriteret e marrjes në punë të personelit të zyrave rajonale

Kandidati aplikues për punonjës rajonal i AKPA-s duhet të përmbushë kriteret, si më poshtë:
1. Kritere të përgjithshme:
a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
2. Kritere të posaçme për përgjegjësin e sektorit:
a) të ketë diplomë të studimeve universitare "Master shkencor" (ose të barasvlershëm me të);
b) të ketë jo më pak se 3 vjet përvojë pune;
c) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;
d) të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe/ose të gjuhëve të tjera (preferohet).
3. Kritere të posaçme për specialistin:
a) të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit *Bachelor*;
b) të ketë njohuri të përditësuara të teknologjisë së informacionit;
c) njohja e një gjuhe të huaj përbën avantazh.".

2. Neni 14 ndryshohet si vijon:

"Neni 14
Shpallja e vendit të lirë për pozicionin e personelit rajonal të AKPA-s

1. AKPA-ja shpall vendin e lirë për personel rajonal, pasi vendi i punës mbetet vakant.
2. Njoftimi bëhet në faqen elektronike të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të zyrës rajonale (nëse ka), si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të ambienteve të zyrës rajonale, që ka vendin vakant.

3. Shpallja përmban kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për marrjen në punë të personelit rajonal të AKPA-s, dokumentet që duhet të paraqiten dhe afatin e aplikimit, që është jo më pak se 5 ditë pune dhe jo më shumë se 15 ditë pune nga data e shpalljes së vendit të lirë.".

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi MFE-ja dhe AKPA-ja.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj